



Asociacioni i Komunave të Kosovës

Raport nga Takimi i Kolegjiumit të Zyrtarëve Ligjor të Komunave të Republikës së Kosovës

Për: Shefat/Zyrtarët Ligjor të Komunave
Nga: Shqipe Arifaj – Zyrtare Ligjor e AKK-së
Kopje: z.Sazan Ibrahimimi – Drejtor Ekzekutiv i AKK-së
Data : 23 shkurt 2011
Subjekti : Raporti i takimit të parë të Kolegjiumit të Zyrtarëve Ligjor



23 shkurt 2011, Salla e Kuvendit Komunal Ferizaj

Rruga "Gustav Mayer" nr.5, te.038/245-732;245-734;245-735 fax.038-245-733

HYRJE

Asociacioni i Komunave të Kosovës(AKK) organizoi takimin e parë të Kolegjiumit të Zyrtarëve Ligjor të Komunave të Republikës së Kosovës të AKK-së, për vitin 2011.

Qëllimi i takimit mbledhja e zyrtarëve ligjor për të shqyrtuar raportin e punës për vitin 2011, zgjedhja e kryesisë së re Kolegjiumit, plani i punës për vitin 2011, si dhe çështje tjera të cilat janë pjesë e punës së KZL-së.

Në këtë takim morën disa prej zyrtarëve ligjor të Komunave dhe zyrtarja ligjore e AKK-se znj.Shqipe Arifaj .

PËRMBLEDHJE

Takimin e hapi dhe kryesoi kryesuesi i KZL-së **z.Agim Salihu**, i cili fillimisht i përshëndeti zyrtaret e Komunes së Ferizajit si nikoqir të takimit dhe të gjithë të pranishmit në mënyrë të veçantë **z.Bajrush Xhemaili Kryetari i AKK-së** dhe njëherit Kryetari i Komunës së Ferizajit, i cili edhe mori fjalën – Erdha të ju përshëndes, sepse jeni kolegjium i veçante dhe shumë i rëndësishëm për Komuna. Prej jush varen shumë vendime dhe fjala e juaj është fjala e parafundit. Kolegjiumet janë krijuar për ngritjen cilësisë nëpër komuna dhe jemi model për rajonin, pasi që kolegjiumet janë treguar shumë të suksesshme. Unë ju dëshirojë punë të mbarë në takim dhe suksese.

Pas fjalës përshëndetëse të z.Xhemaili , takimi vazhdoi me rrjedhën e zakonitë , nga z.Salihu i cili më pastaj paraqiti rendin e punës:

1. Shqyrtimi i raportit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës për vitin 2010;
3. Miratimi i propozim-rregullores së punës së KZL-së;
4. Zgjedhja e kryesisë së KZL-së;
5. Miratimi i planit të punës për vitin 2011-përcaktimi i dy prioriteteve dhe
6. Të ndryshme.

Pika e parë: Shqyrtimi i raportit nga mbledhja e kaluar

U miratua, pa asnjë vërejtje.

Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës për vitin 2010

z.A.Salihu – Në raport janë përfshirë pikat që janë diskutuar gjatë pesë takimeve të KZL-së gjatë vitit 2010 si dhe rekomandimet që kanë dalë nga këto takime, pastaj dokumentet që kanë dal si produktë i KZL-së, si dhe aktivitetet tjera që kemi pasur me partnerë të AKK-së. Në raport nuk kemi hy në detale, edhe pse ne e dimë që disa zyrtarë nuk kanë mundur të marrin pjesë në takime për arsye teknike dhe mos përkrahje sa duhet nga strukturat udhëheqëse komunale, mirëpo raporti i punës konsiderohet kontribut i të gjithë anëtarëve të KZL-së.

Pastaj diskutoi edhe **znj.Qerime Koci** – e cila më shumë foli për mënyrën e organizimit të takimeve dhe disa çështjeve teknike, për të cilat çështje iu përgjigj zyrtarja ligjore e AKK-së.

Për raportin e punës diskutoi edhe **z.Hevzi Matoshi** – i cili tha se në raport të punës është përfshi puna profesionale e të gjithë neve. Në planin e punës për vitin 2011 duhet të përfshi aktivitetet të cilat nuk kanë mundur të realizohet gjatë vitit 2010, dhe kontributi i të gjithë anëtarëve është puna që ka bërë KZL-ja gjatë vitit 2010 kush më shumë e kush më pak.

Raporti i punës së KZL-së për vitin 2010 u miratua njëzëri .

Pika e tretë : Miratimi i propozim-rregullores së punës së KLZ-së

z.A.Saliu – Draft-rregullorja e punës është punuar nga një grup juristësh që i ka caktuar AKK-ja dhe ky draft i është prezantuar të gjitha Kolegjiumeve pra është i njëjtë për të gjithë,por ne mund të bëjmë plotësime ku e shohim të nevojshme.

Znj.Drita Hashani- dha vërejte në neni 10, nuk duhet të jetë vendime po rekomandime, pastaj **z.Flamur Vula**, dha vërejtje në preambulën e rregullores, **z.Faik Gashi** dha vërejtje në afatin e mandatit të kryesisë mos të jetë katër vjet por dy vjet, si dhe renditja te ndryshoj ne faqen e parë të rregullores.

z.A.Saliu – Ne vërejtjet e arsyeshme do t'i inkorporojmë në rregullore dhe në takimin e ardhshëm do të ju prezantohet dhe pastaj do ta miratojmë .

Pika e katërtë: Zgjedhja e kryesisë së KZL-së

z.A.Saliu – Sipas rregullores së punës, kryesia e Kolegjiumit duhet të zgjidhet e re, andaj kërkoj nga ju që të filloni me propozimet, për anëtar të kryesisë.

Pas propozimeve dhe votimeve nga anëtarët e KZL-së u zgjodh kryesia e KZL-së:

1. Agim Salihu, shef i zyrës ligjore Komuna e Prishtinës - Kryesues i Kolegjiumit ;
2. Hevzi Matoshi, shef i zyrës ligjore Komuna e Gjilanit – zv. Kryesues i Kolegjiumit ;
3. Drita Hashani, zyrtare ligjore Komuna e Obiliqit- anëtar e kryesisë së Kolegjiumit ;
4. Bajrush Laqi, zyrtar ligjor Komuna Hani i Elezit – anëtar i kryesisë së Kolegjiumit;
5. Vend i rezervuar për komunat e reja;

Pika e pestë: Miratimi i planit të punës për vitin 2011-përcaktimi i dy prioriteteve

z.A.Saliu – Nga zyrtarët e AKK-së është përgatitur nj model plan për të gjitha kolegjiumet në bazë të Strategjisë së AKK-së dhe planit të punës së AKK-së, pastaj ne i përcaktojmë dy prioritetet për vitin 2011, objektivat dhe aktivitetet që do t'i zhvillojmë gjatë gjashtë takimeve që duhet ti mbajmë në vitin 2011.

Nga të gjithë zyrtarët pati propozime të ndryshme nga z.Avni Hoda, z.Ali Shala, znj.Drita Hashani, z.Hevzi Matoshi, z.Agim Salihu, z.Guri, z.Faik Gashi dhe kërkesa se çfarë kanë nevojë të diskutojnë dhe çfarë është e nevojshme për komuna dhe u përcaktuan prioritetet objektivat dhe aktivitetet për KZL-në.

Pjesë e kësaj pikë është dokumenti shtesë i këtij raporti - Plani Vjetor për Vitin 2011 për KZL-në

REKOMANDIME

- ❖ Të organizohet një takim i KZL-së së bashku me Menaxherët e Personelit të Komunave, për të diskutuar Ligjin për Shërbimin Civil dhe Ligjin e Pagave ;
- ❖ Për veç takimeve të rregullta të parapara në plan të punës të mbahen edhe takime tjera sipas nevojës;
- ❖ Të kontaktohet me ministrinë përkatëse për rregullimin e pozitës së zyrtarëve ligjor nëpër komuna;